

VENDIM
Nr.292, datë 14.4.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.901, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/ NËPUNËSVE, NËPUNËSVE TË KABINETEVE DHE PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E DISA INSTITUCIONEVE TË PAVARURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.901, datë 19.12.2007, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 1, të shtohet emërtesa “Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

b) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pas pikës 2 të shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Kryetari i bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, përfiton një shpërblim për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj, në masën 30% të pagës së drejtorit ekzekutiv të Institutit. Nënkryetari dhe anëtarët e bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, përfitojnë një shpërblim për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj, në masën 20% të pagës së drejtorit ekzekutiv të Institutit.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e miratuara tashmë për këtë institucion për vitin 2011 dhe për:

a) kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, të fillojnë nga data 1 janar 2011;

b) nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të këtij Instituti, të fillojnë nga data e emërimit të tyre në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha